

## TERROROLOGJIKA E ORIANA FALAÇIT

Më ka ndodhur të lexoj libra të fortë polemistë e replikues, të përshkuar nga nervi, indinjata dhe ndjenja e mprehtë e shpagimit për fyerjen; libra që vënë gjithçka në sulm; libra-teh kame; libra që e tejkalojnë zemërimin dhe kalojnë përmatanë tij - në mllef; libra cinikë, që gjithmonë tejkalojnë të drejtën e replikuesit. Mund t'i numërosh libra të tillë edhe brenda kulturës tonë dhe asaj të huaj. Do të thoni: Emëroni, të paktën një. Unë përgjigjem: Ka shumë. Supozojmë se ju këmbëngulni, të paktën një, mundësisht nga kultura jonë. Unë përgjigjem: "Morfologjia e një fushate" e R. Qoses, për shembull. Libra të tillë ka plot. Që në lashtësi. Aq me tepër sot. Me frymën e linçimit dhe shpartallimit të kundërshtarit. Ata u ngjajnë zemërimit të Akilit të përjetshëm, që dhunon kufomën e Hektorit të përjetshëm. Kemi parë dhe libra plot shkëlqim, mendjemprehtësi e spekulim filozofik, siç është, fjala vjen, libri filozofik polemizues "Mospërputhja e mospërputhjeve" të Averroes - një maratonë e vëllimshme e diskursit filozofik mesjetar prej mbi njëmijë fletë, ku dijetari-filozof i kundërvihet tezë pas teze paraardhësit të tij të shquar Gazali.

Por libri që keni në dorë nuk është libër-kamë. Si minimum, ai është një mburojë e pashkatërrueshme me logjikën e lidhjes së mendimeve në fjalë; është mburojë nga kama e ngritur për t'u lëshuar mbi trupin e njerëzimit. Dhe librin e ka shkruar një zotëri modest, që nuk është zanatçi librash e botimesh, që nuk ka hallin e shtimit të ndonjë CV-je në listën e gjatë të botimeve që mbushin raftet. Autori, Bardhyl Fico, pinjoll i një familjeje fisnike, i ushqyer me kulturën e të gjithë trashëgimisë kulturore të Lindjes dhe Perëndimit, është një njeri i purifikuar nga urtësia e librave që mëtojnë dashurinë, paqen dhe dinjitetin e njeriut. Prandaj dhe gjuha, dhe argumenti dhe arsyeja e këtyre fletëve të shkruara i referohen dijes që kalon nëpërmjet mendjes dhe zemrës, pa harruar rëndësinë e secilës, që përbën simbiozën e humanizmit të përgjithkohshëm.

Polemika e z. Fico duket sikur përqendrohet në një kundërpërgjigje ndaj mllefit të Oriana Falaçit, një intelektualeje, gazetare dhe shkrimtare e njohur dhe e vlerësuar dikur për etjen e saj në kërkim të së vërtetës, por që mjerisht, shokoi gjithë botën intelektuale me radikalizmin e saj racist, kur pas 11 shtatorit të vitit 2001 botoi librin e saj racist "Tërbimi dhe krenaria" (i përkthyer në shqip "Mllefi dhe krenaria"). Edhe pse libri ka për adresat pikërisht znj. Falaçi, edhe pse baza e polemikës janë idetë dhe patosi i saj urryes e përbuzës ndaj krejt botës islamike, prapëseprapë, do të ishte mjaft i ngushtë konteksti i kundërpërgjigjes vetëm ndaj saj në këtë libër të z. Bardhyl Fico. Tekfundit Oriana Falaçi është pretexti, që s'ka munguar kurrë për të marrë inkursione islamofobike ndaj një kulture të tërë dhe një pjese të madhe të njerëzimit. Vlera e librit është aktuale për çdokënd që cenon, provokon dhe bën atentat mbi imazhin e një pjese të njerëzimit, pavarësisht se cila pjesë është ajo.

Në librin "Mein kampf" i Oriana Falaçit, z. Bardhyl Fico merret me rrënjët e dukurisë së asaj metamorfoze, apo më saktë neuroze, që ka përfshirë konstruktin moral të dijeve intelektuale në Perëndim. Metamorfoza e Falaçit është një sindromë neurotike e alibisë së njeriut të zeherosur, e cila penën e saj e ngjyen në vrer e jo në dhimbjen njerëzore. Stili dhe virtytet e shkrimit të saj bëhen befaz mjete të yshtjes së xhindosur, që shkakton konfrontimin e hapur të kulturave, traditave dhe feve, duke i vendosur ato në një antagonizëm përjashtues me njëra-tjetrën.

Në librin e z. Fico flet urtësia e përvojës diturake të njerëzimit. Teksti i librit është dhënë me një presim e thukje të jashtëzakonshme, që ngërthen një logjikë aforistike. Lakonizmi i fjalëve, referencat e dendura verbale nga kulturat e Lindjes dhe të Perëndimit janë sfondi sintetik i librit, mes të cilit idetë dhe akuzat e zonjës nervoze janë i vetmi absurditet, i cili veçse e thekson se në çfarë greminë dhe theqafjeje mund të udhëhiqet njerëzimi. Papërgjegjshmëria nihiliste dhe homogjenizimi i arsytimit veçse e thellojnë hendekun midis arsyes së bashkëjetesës për mirëkuptim e paqe, për të vërtetuar tezat ndjellazeza të "përplasjes së qytetërimeve". Ligjërimi i Oriana Falaçit ringre edhe njëherë paradigmen e të menduarit monist me pole kategoriale, ku njëri pol duhet medoemos ta asgjësojë polin e përkundërt. Strukturat homogjene

të arsyetimit të saj, prandaj u ngjasin ideve naziste e raciste të Hitlerit, ngase në thelb ato përbëjnë një thirrje tipike mesjetare për ringritjen dhe riaktivizimin edhe njëherë të Kryqëzatave kundër qytetërimit të Lindjes së Mesme, e më përveçmas, kundër botës islame.

Bardhyl Fico, duke shpjeguar thelbin hyjnor të fesë paqësore e ndriçuese të Islamit dhe duke bërë distancimet nga aventurierët kokëkrisur terroristë, i heq bazën "mllefit" të Oriana Falaçit, duke i njehsuar terroristët e çdo feje me terrorologjikën intelektuale të vetë znj. Falaçi. Në faqet e librit shpërthen erudicioni pikant, përthyerja dhe jehona e veprës së profetit Muhamed (a.s), si dhe lavdia e dijetarëve muslimanë, që përbën një trashëgimi të fortë të artit, shkencës, kulturës dhe filozofisë botërore, të cilat janë në gjenezë edhe të qytetërimit perëndimor.

Të nderuar lexues, ndiqni në faqet e këtij libri dramën e urtësisë në përplasje me shkulmet e çmendura; ndiqni arsyen e dashurisë dhe etjen për iluminim mendor e shpirtëror dhe bëni, siç bën autori: faljani marrëzinë e mllefit, me të cilën krenohet zonja me sindromën e pashërueshme të neurozës islamofobike, zonja e tjetërsuar që ka humbur durimin... Dhe pas durimit, gjithçka tjetër njerëzore. Faljani, por mos ia harroni, duke medituar secili në shijimin e librit mbi habinë në formë pyetjeje që ngre autori: "Cili qe ai çast aq i brishtë, që ia mori identitetin Oriana Falaçit?"